



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 182, datë 30.10.2024

**PËR
LICENCIMIN E SUBJEKTIT “E-BUSINESS SOLUTIONS” SH.P.K.,
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENTIT NË SIGURIME,
NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË SHOQËRIVE SË SIGURIMIT
“SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A. DHE “SICRED” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Licencimin e subjektit “E-Business Solutions” sh.p.k., për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, në klasat e jetës, në emër e për llogari të shoqërive të sigurimit “Sigal Life Uniqa Group Austria” sh.a., dhe “SiCRED” sh.a.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR
Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**